



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DRAGASHIT PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Dragashit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Dragashit (Dragash), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 B1 - Klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate në vlerë 183,000€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Dragash kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Dragashit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Dragashit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Dragashit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Dragashit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Dragashit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet^a

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër 4 rekomandime të përsëritura.

Ne do ta përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi i pa saktë i shpenzimeve

Gjetja

Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga “Rezerva” me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore, përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, plani kontabël i Thesarit përcakton kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që organizatat buxhetore duhet të aplikojnë.

Në tri (3) raste të pagesave të ekzekutuara, me vlerë totale prej 183,000€, Komuna i ka regjistruar shpenzimet në kategori të gabuar ekonomike:

- Nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar 105,000€ nga Thesari për vendime përmbartimore për punonjësit e arsimit (paga jubilarë dhe shujta) shpenzimet që për nga natyra e i takojnë pagave dhe mëditjeve, dhe
- Nga kategoria mallra dhe shërbime dy (2) pagesa në vlerë 78,000€ janë paguar OJQ-ve për projekt “Shëndet dhe mirëqenie sociale, edukim dhe ambient të pastër për të gjithë” dhe projekti tjetër “Bëhu partneri im për mirëqenie dhe luftën kundër diskriminimit” në bazë të marrëveshjeve për bashkëpunim dhe bashkëfinancim që për nga natyra këto pagesa i takojnë kategorisë ekonomike subvencione dhe transfere.

Këto gabime kanë ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit të saktë buxhetor për këto lloje detyrimesh në kategorinë përkatëse.

Ndikimi

Shpenzimet e realizuara nga kategori të pasakta ndikojnë në mbivlerësim apo nënvlerësimin e kategorive buxhetore, duke sjellë pasqyrim jo të saktë të shpenzimeve në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF).

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kufijtë buxhetorë të përcaktuar, si dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në RVFe pasurive kapitale është 44,790,643€, pasurive jokapitale është 1,257,716€, si dhe e stoqeve 12,924€.

Çështja B2 - Mangësi në evidentimin e pasurisë

Gjetja

Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu sipas nenit 22 paragrafi 1,2,3 të rreg. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore.

Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Komuna kishte formuar komisione për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe komisionet i kishin hartuar raporte individual të pasurive nën 1,000€, në vlerë financiare prej: 126,628€, për cdo njësi organizative të komunës dhe një raport të përmbledhur për pasuritë mbi 1,000€, në vlerë financiare prej: 8,165,044€, mirëpo nuk kishin përgatitur një raport të përgjithshëm të inventarizimit.

Po ashtu komuna nuk ka arritur t'i regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1,000€ në e-pasuri kjo ka ndodhë për arsye se komuna ka bërë disa shkresa në drejtim të MAPL-së dhe ka pasur disa takime për ta rregulluar sistemin, por nuk ka pasur efekt.

Në testimin e pasurive mbi 1,000€ nuk kemi vërejtur pasuri të cilat nuk janë regjistruar në SIMFK, ndërsa pasuritë nën 1,000€ janë prezantuar në PFV në vlerë totale prandaj, nuk ishte e mundur të identifikohet se cilat pasuri ishin regjistruar dhe a është përllogaritur zhvlerësimi i tërë pasurisë.

Pasuritë nën 1,000€, të prezentuara në PFV për vitin 2025 ishin 1,257,716€, me një zvogëlim krahasuar me vitin e kaluar për 336,761€.

Ndikimi

Mos regjistrimi individual i të gjitha pasurive me detajet e tyre si dhe mos përllogaritja e zhvlerësimit rezulton në prezantim jo të drejtë të PFV dhe mbivlerësim të vlerës së tyre. Mungesa e një raporti të përmbledhur të inventarizimit që përmbanë të gjitha pasuritë e Komunës, pamundëson vërtetimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e saj janë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë nën 1,000€ duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna e Dragashit në RVF e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,585,529€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 2,295,836€, tatimi në tokë 192,996€ dhe shfrytëzimi i prones komunale 96,697€.

Çështja B3 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pages, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna e Dragashit në PFV e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 2,585,529€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 2,295,836€, tatimi në tokë 192,996€ dhe shfrytëzimi i prones komunale 96,697€, vetëm tatimi në pronë është rritur për 894,287€ në krahasim me vitin 2024.

Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme është mospërbushja e detyrimeve ligjore nga ana e komunës për ndjekjen dhe mbledhjen e borxheve tatimore.

Ndikimi

Mungesa e mekanizmave dhe efikasitetit për inkasim të borxheve nga debitort mund të shkaktoj probleme në përmbaruesin e planit të shpenzimeve, ndërsa vjetërsia e tyre zvogëlon gjithnjë e më shumë gjasat që borxhi të inkasohen.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbaruesin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Funkcioni i auditimit të brendshëm

Përveç planit strategjik, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte hartuar edhe planin vjetor të punës për vitin 2025, i cili përfshinte pesë auditime. Të gjitha auditimet e planifikuara janë realizuar gjatë vitit, dhe ato janë përqendruar në këto fusha kryesore: pasuria, subvencionet, prokurimi, shpenzimet dhe auditimi sipas kërkesës. Auditimet kanë mbuluar kryesisht periudhën e vitit 2025.

Çështja B4 - Mos kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Gjetja	Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit public, neni 5.1.1 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë se paku tre auditor. Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Dragashit, përbëhet vetëm nga Udhëheqësi i Njesisë së auditimit dhe nuk ka anëtar tjerë si auditor të brendshëm. Komuna nuk ka ndërmarre veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e përberjes dhe funksionit të Njesisë së Auditimit të brendshëm për ta kompletuar me staf të duhur.
Ndikimi	Mos kompletimi i NjAB-së, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohe sa me të hershme.
Rekomandimi B4	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshem sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	12,872,214	13,515,030	12,879,487	12,415,698	10,990,130
Grante Qeveritare - Buxheti	12,321,160	12,742,103	12,253,872	11,526,631	10,212,979
Të bartura nga viti i kaluar	0	87,239	80,151	207,788	191,599
Të hyrat vetanake	551,054	551,054	423,785	457,800	423,897
Donacionet vendore	0	3,001	3,000	721	18,396
Donacionet e jashtme	0	131,632	118,679	222,757	143,259

Buxheti final është rritur nga 12,872,214€ në 13,515,030€, që paraqet një rritje prej rreth 642,816€ ose afërsisht 5%.

Në vitin 2025 janë realizuar shpenzime në vlerë prej 12,879,487€, që përfaqëson rreth 95% të buxhetit final, duke treguar një nivel të lartë të ekzekutimit buxhetor.

Struktura e financimit paraqet:

- Grantet qeveritare - buxheti mbeten burimi kryesor i financimit me realizim prej 12,253,872€;
- Të barturat nga viti i kaluar kanë kontribuar me 87,239€, duke ndihmuar në financimin e aktiviteteve;
- Të hyrat vetanake në vlerë 551,054€ janë realizuar pjesërisht me 423,785€; dhe
- Donacionet vendore dhe të jashtme kanë ndikim më të kufizuar, ku donacionet e jashtme janë realizuar në 118,679€, ndërsa ato vendore në 3,000€.

Në krahasim me vitet 2024 dhe 2023, shpenzimet e përgjithshme janë të qëndrueshme, me rritje të lehtë.

Struktura e financimit paraqet:

- Grantet qeveritare - buxheti mbeten burimi kryesor i financimit me realizim prej 12,253,872€;
- Të barturat nga viti i kaluar kanë kontribuar me 87,239€, duke ndihmuar në financimin e aktiviteteve;
- Të hyrat vetanake në vlerë 551,054€ janë realizuar pjesërisht me 423,785€; dhe
- Donacionet vendore dhe të jashtme kanë ndikim më të kufizuar, ku donacionet e jashtme janë realizuar në 118,679€, ndërsa ato vendore në 3,000€.

Në krahasim me vitet 2024 dhe 2023, shpenzimet e përgjithshme janë të qëndrueshme, me rritje të lehtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	12,872,214	13,515,030	12,879,487	12,415,698	10,990,130
Pagat dhe mëditjet	6,154,543	6,575,486	6,575,085	5,814,725	5,502,589
Mallrat dhe shërbimet	1,513,342	1,521,303	1,416,839	1,233,214	1,148,879
Komunalitë	400,000	400,000	380,614	198,986	148,244
Subvencionet dhe transferet	400,000	402,659	374,118	357,341	410,610
Investimet Kapitale	4,404,329	4,615,582	4,132,831	4,811,433	3,779,807


Shpenzimet totale për vitin 2025 janë realizuar në vlerë prej 12,879,487€, që përfaqëson rreth 95% të buxhetit final, duke reflektuar një nivel të lartë të realizimit buxhetor.

Ndryshimet sipas kategorive ekonomike janë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje është rritur për 420,943€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet për vitin 2025 janë realizuar në vlerë prej 6,575,085€, që paraqet pothuajse 100% realizim të buxhetit final.
- Buxheti final për mallrat dhe shërbimet është rritur lehtë për 7,961€ krahasuar me buxhetin fillestar. Realizimi për vitin 2025 është 1,416,839€, që paraqet rreth 93% të buxhetit final.
- Buxheti për komunalitë ka mbetur i pandryshuar në 400,000€. Shpenzimet për vitin 2025 janë realizuar në vlerë prej 380,614€, që përfaqëson rreth 95% të buxhetit final.
- Buxheti final për Subvencionet dhe transferet është rritur për 2,659€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në vlerë prej 374,118€, që paraqet rreth 93% realizim të buxhetit final.
- Buxheti final për investime kapitale është rritur për 211,253€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet për vitin 2025 janë realizuar në vlerë prej 4,132,831€, që paraqet rreth 90% të buxhetit final.

Në përgjithësi, struktura e shpenzimeve dominohet nga pagat dhe mëditjet, ndërsa investimet kapitale mbeten komponenti më i madh pas tyre.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Komuna për vitin 2025 kë pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë 82,197€ të cilat alokohen për shpenzim në baza të rregullta tremujore. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme, pasi ato planifikohen dhe realizohen nga Ministria e Punëve të Brendshme po ashtu, nuk janë përfshirë as të hyrat nga gjobat e shqiptuara nga gjykatat, në vlerë prej 2,260€ dhe të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve në vlerë 14,042€.

Të hyrat totale të planifikuara dhe të realizuara janë në nivel të njëjtë buxhetor prej 551,054€, ndërsa realizimi në vitin 2025 është 472,541€, që përfaqëson rreth 86% të planit buxhetor. Realizimi i të hyrave lidhet me arkëtimin nga tatimi në pronë, taksa për lejet e ndërtimit, taksat rrugore, qiraja, tarifat për lëshimin e certifikatave, si dhe nga shërbime të ndryshme administrative, etj.

- Të hyrat tatimore janë realizuar në 271,410€, që përfaqëson rreth 89% të planifikimit;
- Të hyrat jo tatimore janë realizuar në 200,621€, që përfaqëson rreth 81%, duke treguar nën-realizim më të theksuar në këtë kategori; dhe
- Të hyrat tjera janë minimale dhe pa ndikim të rëndësishëm në total.

Në krahasim me vitin 2024 dhe 2023, vërehet një stabilitet i përgjithshëm i të hyrave, me luhatje të vogla ndër vite.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	551,054	551,054	472,541	442,235	504,936
Të hyrat tatimore	304,672	304,672	271,410	251,945	324,438
Të hyrat jo tatimore	246,382	246,382	200,621	187,759	180,498
Të hyrat tjera	0	0	509	2,531	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2024 të Komunës së Dragashit (KD) ka identifikuar gjashtë (6) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KD ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2025, dy (2) nga rekomandimet ishin zbatuar me sukses, ndërsa katër (4) ende nuk janë zbatuar.

Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që njësitë përkatëse të zbatojnë në mënyrë të rregullt kushtet kontraktuale, përfshirë monitorimin e afateve të dorëzimit dhe aplikimin e menjëhershëm të ndëshkimeve në rast të vonesave si dhe është e domosdoshme që urdhërblertet të nënshkruhen dhe formalizohen në përputhje me rregullat, për të garantuar një zbatim të drejtë të kontratave nga zyrtarët përgjegjës.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet e sakta buxhetore, ose të bëhet ridestinimi i mjeteve kur është e nevojshme, në mënyrë që të gjitha pagesat të regjistrohen sipas kodeve të duhura ekonomike të planit kontabël.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet financiare dhe të sigurojë hartimin e një analize të detajuar buxhetore, në mënyrë që të gjitha obligimet të paguhen me kohë dhe të shmangen vonesat.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e saj janë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë nën 1,000€ duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Dragashit, për vitin 2025.
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bexhet Xheladini

Pozita: (Kryetar i Komunës),

Data: Qershor, 2026.

Nënshkrimi:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
02 Nr. Br. 4016/11311/26
26.06.2026
Dragash - Dragaš

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare' duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet', duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ^a Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ^η Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ['] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ['] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.